



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.30.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT RREGULLATIV**  
**TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendos në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare , në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderren, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Udhëheqësja e Ekipit, Sabile Muli dhe anetare, Flora Berisha.

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                     |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje e përgjithshme .....                                                    | 4  |
| 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....  | 6  |
| 2 Qeverisja.....                                                                    | 9  |
| 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....                                            | 13 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....                                 | 19 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP ..... | 20 |
| Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....                                    | 22 |


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 02/11/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


#### **Opinion i pamodifikuar**

Pasqyrat vjetore financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti varësisht prej lloji të opinionit.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



## Përgjigja e Kryetarit - Auditimi 2015

Kryetari ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### **Opinioni i pamodifikuar**

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të ARKEP-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194 si dhe Rregullën financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

### **Baza për Opinionin**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga ARKEP-i dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Kryetari i ARKEP-it është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Kryetari i ARKEP-it është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARKEP-it.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

ARKEP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmëri me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetvlerësimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

Në draft pasqyrat financiare ishin të nevojshme disa korrigjime financiare dhe ne kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar hyrjen e parasë së gatshme, shpalosjet përshkruese dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve si në vijim:

- Te neni 13 - Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit – te shtylla e donacioneve të buxhetuara është paraqitur vlera prej 5,476€. Pasi kjo vlerë ka të bëjë me bartjen e donacioneve nga vitet e kaluara, ajo nuk duhet të prezantohet si hyrje e parasë së gatshme në llogari të thesarit për vitin 2015. Po ashtu informatat te shënimi 16 lidhur me nenin 13 të PVF-ve nuk duhet të shpalosen, derisa te shënimi 4 lidhur me nenin 12 të PVF-ve (Grandet e përcaktuara të donatorëve) shpalosin detajet për prezantim të donacioneve; dhe
- Te neni 15 - (Shpalosja e detyrimeve) Faturat e pranuar por të papaguara duhet të prezantohen veçmas nga obligimet për punën apo shërbimin e kryer në dhjetor të 2015, dhe që faturat janë pranuar në janar të vitit 2016.

### DEKLARATA E BËRË NGA ZKA DHE ZKF

ARKEP ka bërë korrigjimet e sugjeruara në PVF dhe marrë parasysh këtë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë, dhe në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

## 1.4 Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.



## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ARKEP-in që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuar për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të: fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë disa çështje të qeverisjes brenda ARKEP-it veçanërisht në lidhje me vendosjen e objektivave strategjike dhe menaxhimin e rrezikut si dhe lidhur me strukturën organizative. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga ARKEP-i e pasqyron këtë situatë në mënyrë të drejtë, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që bazohen në dëshmi.

### 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të ARKEP-it ka rezultuar në 4 rekomandime kryesore. ARKEP kishte përgatitur një Plan Veprimi për implementimin e tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, të gjitha rekomandimet janë implementuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe për implementimin e tyre, shihni shtojcën III.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ARKEP-in më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

---

### Çështja 1 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

#### E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;
2. ARKEP ende nuk ka të miratuar statutin dhe rregulloren e re të punës të paraparë me ligjin e komunikimeve elektronike;
3. ARKEP ka të miratuar skemën organizative nga viti 2013, por deri tani ka rritje të pozitive me përgjegjësi të përcaktuara me dokumentin strategjik të qeverisë e që ende nuk janë miratuar nga bordi apo reflektuar në strukturën organizative;
4. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen si të vendosura nga ARKEP. Çdo vit ARKEP organizon punëtori ku marrin pjesë një numër i stafit që kontribuojnë në rishikimin e planit strategjik, përgatitjen e programit vjetor dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), duke përfshirë dhe kalkulimin e kostos së plotë; dhe
5. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura dhe të mbështetura nga ARKEP-i.

- Rreziku** Çështjet e identifikuar në aspektin e qeverisjes ndikojnë në proceset strategjike operative dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara përmes aktiviteteve të nevojshme.
- Rekomandimi 1** Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i çështjeve të theksuar në mënyrë pro aktive. Miratimi i statutit dhe rregullores se re të punës duhet të konsiderohet prioritet, po ashtu edhe ndryshimet në pozita të reflektohen në skemën organizative të ARKEP-it.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ARKEP operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

### 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në Rregullën Financiare të thesarit 01/2010 – Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli kërkojnë vlerësimin e rrezikut, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve relevante ndaj arritjes së objektivave që formojnë bazën për të përcaktuar se si duhet të menaxhohen rreziqet.

---

#### Çështja 2 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Pyetësi i vetvlerësimit i plotësuar nga ARKEP-i ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. ARKEP ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërliken me arritjen e objektivave.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut mund të zvogëlojë cilësinë e shërbimeve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet e nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.

## 2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Zyrtari Kryesor Financiar nuk përmban ndonjë softuerë të kontabilitetit, por të gjitha raportet financiare përgatiten në formatin Excel, shënimet janë të qarta, në detaje dhe të klasifikuara. Në përgjithësi, formati i raporteve menaxheriale ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore azhurnohen në baza mujore.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), Organizata buxhetore nuk i plotëson kriteret<sup>1</sup> për themelimin e kësaj njësie. ARKEP, nuk ka buxhetin vjetor mbi një milion euro dhe numri i stafit nuk arrin mbi 50 të punësuar me orar të plotë, Prandaj ARKEP nuk është e obliguar të themeloj NJAB-në. Mirëpo, në raste të veçanta nëse organizata buxhetore parasheh shkallë të lartë të rrezikshmërisë, mund të krijojë NJAB me propozimin e Njesisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm dhe pëlqimin paraprak të Ministrit për Ekonomi dhe Financa.

Megjithatë, me qëllim të mbështetjes së veprimtarisë së entitetit në kornizën ligjore që rregullon marrëdhëniet në fushën buxhetore, financiare, të prokurimit, si dhe ligjet tjera të zbatueshme, ARKEP duhet të konsideroj mundësit për kryerjen e auditimit të brendshëm në organizatë.

---

<sup>1</sup> Buxheti vjetor duhet të jetë mbi një milion euro dhe të ketë mbi 50 të punësuar me orar të plotë.

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Vlera e bartur si kursime apo suficit mbetet si shqetësim që po përsëritet vit pas viti. Për shkak të vonesave në plotësimin e numrit të stafit dhe realizimit të projekteve me kohë, buxheti i ARKEP-it po pëson ndryshime përkatësisht shkurtime buxhetore. Çështjet lidhur me kompensimet për pagat (bordi i ARKEP-it) për muajin dhjetor 2015 duhet të merret në konsideratë dhe të trajtohet sipas rregullave. Po ashtu, kërkesat për shtesa për paga dhe mëditje duhet të trajtohen që të jenë në përputhshmëri me rregullat apo vendimet e përcaktuara nga qeveria.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për 2015, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)**

| Përshkrimi                 | Buxheti fillestar | Buxheti Final  | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi | 2013 Realizimi |
|----------------------------|-------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Burimet e Fondeve:         | <b>756,301</b>    | <b>648,863</b> | <b>617,944</b> | <b>780,465</b> | <b>682,713</b> |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 756,301           | 643,387        | 612,468        | 776,034        | 682,713        |
| Donacionet e jashtme       | 0                 | 5,476          | 5,476          | 4,431          |                |

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 107,438€. Kjo ulje është aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2015, ARKEP ka përdorur 95% të buxhet final ose 617,944€, me një përmirësim prej 14% krahasuar me vitin 2014. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

| Përshkrimi                                              | Buxheti fillestar | Buxheti Final  | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi | 2013 Realizimi |
|---------------------------------------------------------|-------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b> | <b>756,301</b>    | <b>648,863</b> | <b>617,944</b> | <b>780,465</b> | <b>682,714</b> |
| Pagat dhe Mëditjet                                      | 416,206           | 367,115        | 367,115        | 320,111        | 289,558        |
| Mallrat dhe Shërbimet                                   | 327,395           | 270,622        | 239,836        | 249,543        | 259,370        |
| Shërbimet komunale                                      | 12,700            | 11,125         | 10,993         | 11,213         | 12,390         |
| Investimet Kapitale                                     |                   |                |                | 199,598        | 121,396        |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për mallra dhe shërbime, përfshirë dhe komunalit ishte reduktuar për 58,348€, për shkak të mos realizimit të disa projekteve me kohë. Projekti i planifikuar për furnizim me material shpenzues ishte vendosur nga qeveria që të ushtrohet nga Autoriteti i Prokurimit Publik, derisa projekti i planifikuar për "shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilluese" nuk është realizuar ngase nuk kishte nevojë për shërbime të tilla gjatë vitit. Po ashtu janë paraqitur vonesat në realizimin e disa projekteve, si pasojë e ngecjeve me procesin e prokurimit.
- Ulja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 49,091€ është si rezultat i mosplotësimit të numrit të stafit deri në muajin Maj të vitit 2015.

**Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)**

| Përshkrimi       | Buxheti fillestar | Buxheti Final    | 2015 Pranimet     | 2014 Pranimet    | 2013 Pranimet    |
|------------------|-------------------|------------------|-------------------|------------------|------------------|
| Të hyrat vetjake | 4,030,000         | 4,030,000        | 19,278,968        | 3,941,666        | 5,524,640        |
| <b>Totali</b>    | <b>4,030,000</b>  | <b>4,030,000</b> | <b>19,278,968</b> | <b>3,941,666</b> | <b>5,524,640</b> |

Krahasuar me vitet e kaluara vërehet një rritje dukshëm më e lartë e realizimit të të hyrave. Rritja ka rezultuar nga dhënia e të drejtës së shfrytëzimit të radio spektrit frekuencor<sup>2</sup> për operatorin IPKO dhe TELEKOMI I KOSOVËS. Kjo e drejtë është dhënë për periudhën dhjetor 2015 deri në korrik 2019 me një çmim total prej 33,391,463€. Prej tyre , 14,813,763€ janë paguar gjatë vitit 2015. Pjesën e mbetur prej 18,577,700€ operatorët përkatës do të duhet ta paguajnë në vitet e ardhshme.

<sup>2</sup> Radio spektri në brezin frekuencor 1800 MHz për periudhën 2015-2019

### Çështja 3 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Planifikimi i buxhetit fillestar ka pësuar ndryshime deri në realizimin final. Mungesa e projekteve specifike ka ndikuar në shfrytëzim joefikas të buxhetit duke bërë që pjesa e mbetur të bartet si kursime apo suficit në Buxhetin e Kosovës. Po ashtu edhe realizimi i të hyrave ka diferencë të konsiderueshme nga planifikimi i tyre, si rezultat i kërkesave të reja nga dy OE për të drejtën e shfrytëzimit të radio spektrit frekuencor.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe mos realizimi i projekteve me kohë rrezikon të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në reduktimin e buxhetit për vitet e ardhshme.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

## 3.4 Prokurimi

Sfidat rreth planifikimit dhe implementimit të projekteve kapitale të vitit 2014 kanë ndikuar në zvogëlimin e buxhetit për projektet kapitale të vitit 2015.

Për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, gjithsej janë nënshkruar 19 kontrata me vlerë totale prej 88,715€. Prej tyre, për 14 kontrata implementimi vazhdon edhe gjatë vitit 2016.

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave bëhen nga Divizioni i pagave në Ministria e Financave derisa organizata buxhetore bën aprovimin e listës për paga dhe mëditje.

Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 367,115€, dhe shpenzimet ishin 367,115€ ose 100%. Numri i nëpunësve të planifikuar ishte 39, numri aktual në dhjetor të vitit 2015 ishte 38, prej tyre pesë janë anëtar të Bordit.

Me 15 dhjetor të vitit 2015 ka përfunduar mandati për bordin e kaluar, dhe me kohë është bërë dorëzimi i detyrës tek bordi i ri. Mirëpo për muajin dhjetor është paguar paga e plotë për ish anëtarët e bordit. Kjo për arsye se procesimi i pagave bëhet para datës 15 dhjetor. Kjo çështje mbetet të rishikohet në auditimin e ARKEP-it për vitin 2016.

---

#### Çështja 4 – Aplikimi i të drejtës së shtesave – Prioritet i Lartë

- E gjetura** Në vitin 2008 është miratuar vendimi 02/39 nga qeveria e Kosovës për shtesat në pagë për nëpunësit e Teknologjisë Informative (TI) në të gjitha organizatat buxhetore. Megjithatë, ARKEP ende nuk e ka aplikuar shtesën<sup>3</sup> për zyrtarin e TI siç parashihet me vendim.
- Rreziku** Mos aplikimi i shtesave për pozitën në TI ndikon në demotivimin e punonjësit e që mund të reflektohet edhe në rezultatet në punë. Për më tepër kjo gjendje mund të sjell organizatën në kompensime tjera të cilat ndikojnë në procesin e buxhetit dhe shpenzimeve.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të siguroj që kërkesat për kompensimet (pagat dhe mëditjet) e stafit në organizatë janë përmbushur në përputhje me rregullat ligjore. Njëkohësisht, të siguroj se kjo çështje është trajtuar përsëri në MAP dhe të identifikoj pengesat e paraqitura.

---

<sup>3</sup> Ndonëse shtesa duhet të aplikohet nga viti 2008, ARKEP në vitin 2015 ka bërë kërkesën në Ministrinë e Administrimit Publik për aprovimin e shtesës mbi pagën bazë.



## 3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga ARKEP në 2015 ishin në vlerë 19,278,968€. Ato kanë të bëjnë me pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, pagesat për financimin e shërbimeve universale, pagesat për përcaktimin dhe përdorimin e frekuencave, pagesat për dënimet ekonomike të shqiptuara nga Autoriteti, çdo taksë tjetër e paraparë me Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike dhe Ligjin Nr. 03/L-173 Për Shërbimet Postare si dhe/apo legjislacionin sekondar (korniza e akteve rregullatorë) të nxjerr nga Autoriteti.

---

### Çështja 5 - Autorizime të përgatitura në mënyrë manuale dhe llogaritja e tarifave - Prioritet i Lartë

**E gjetura** ARKEP posedon sistemin SPECTRA i furnizuar nga LS - Telcom për menaxhimin e dhënies së autorizimeve dhe llogaritjen automatike të frekuencave, por që i njëjti nuk është në funksion për arsye të mos mirëmbajtjes. Po ashtu edhe programi për të hyra përkatësisht për faturim dhe regjistrimin e të hyrave ka dobësi në informata. Raportet nga ky program nuk mund të gjenerohen në mënyrë elektronike as fizike. Derisa për raportim shfrytëzohen të dhënat e mbajtura në mënyrë manuale në format të MS Excel.

**Rreziku** Mos funksionimi i duhur i softuerit dhe programit për të hyrat mund të rezultojë në gabime të të dhënave. Kjo mund të reflektoj edhe në raportim të informatave dhe në mos efikasitet brenda proceseve të menaxhimit të të hyrave.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të konsideroj funksionimin e softuerit ekzistues me të cilin bëhen llogaritjet në mënyrë automatike sa i përket frekuencave dhe dhënien e autorizimeve. Po ashtu, programi për të hyrat duhet të funksionalizohet me qëllim të ruajtjes së informatave dhe raportimeve të sakta.

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrat kontabël (SIMFK), me vlerë mbi 1,000€ pasuri jo-financiare kapitale të ARKEP-it ishin 893,217€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi verifikuar nëse ekziston fizikisht pasuria e evidentuar në regjistrat e pasurisë.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

### 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Të hyrat e pa mbledhura dhe të prezantuara në PVF ishin 521,034€. Prej tyre 141,274€ janë fatura të papaguara nga vitet paraprake, ndërsa 379,760€ janë obligime vijuese të përcaktuara sipas faturës ose vendimit të 2015.

ARKEP, bazuar në kornizën ligjore, ka përdorur të gjitha procedurat e mundshme për të inkasuar të arkëtueshmet e tyre. Në raste të mos ekzekutimit të urdhrave dhe dënimeve nga shkelësit/kundërvajtësit, ARKEP, ka proceduar inicimin e procedurave gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7.3 Trajtimi i obligimeve

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 5,225€. Prej tyre 818€ janë fatura të papaguara për arsye të vonesave për pranimin e faturave, dhe 4,407€ janë obligime ligjore për të cilat shërbimi është kryer në dhjetor të vitit 2015, por që faturat janë pranuar në janar të vitit 2016.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që mund të konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë

një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit                        | Rekomandimet e dhëna                                                                                                                                                                                                                               | Të implementuara                                                                                                                                                                  | Të adresuara por jo të implementuara | Të pa adresuara |
|-----------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|-----------------|
| 1. Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak | Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.         | ARKEP ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar, dhe ka marr masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve. |                                      |                 |
| 2. Ekzekutimi i buxhetit                      | Kryetari duhet të vlerësoj në mënyrë sistematike arsyet për ekzekutim të ulët të buxhetit dhe të përcaktoj praktikat për përmirësim dhe të adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.                                | Ekzekutimi i buxhetit është realizuar 95% e buxhetit final.                                                                                                                       |                                      |                 |
| 3. Procedurat e Prokurimit                    | Kryetari duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe për të vënë kontrollë më të fuqishme për të siguruar se dobësitë sistematike janë eliminuar. | Ky rekomandimin është adresuar plotësisht, Kryetari kishte ndërmarrur hapa për përmirësimet sipas rekomandimit të ZAP dhe në këtë fazë nuk kemi hasur në vërejtje të njëjta.      |                                      |                 |

|                                                   |                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |  |  |
|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
| 4 - Themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm | Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet deri në themelimin e NJAB-së. Në mungesë të kësaj njësie, shërbimet e auditimit të brendshëm duhet të sigurohen në një mënyrë tjetër. | Bazuar ne Ligjin Nr. 05/L-001 mbi ndarjet buxhetore, buxheti i ARKEP për vitin 2015 është 756,301€ (pra ndjeshëm më i vogël se 1 milion euro) dhe bazuar në përcaktimin dhe kriteret ligjore sipas Ligjit Nr. 03/L-128 dhe nenit 3 te UA Nr. 23-2009 – për themelimin e NJAB, vlerësohet se ky rekomandim nuk kërkohet që të realizohet gjatë vitit buxhetor 2015. |  |  |
|---------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|